

AKT THEMELIMI
SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"BIRDING ALBANIA SHPK.

Sot, në Tiranë, më **01.02.2024**, bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "BIRDING ALBANIA " SHPK.

Unë ortaku i vetëm Mirjan TOPI, e biri i Hazbedinit, i datëlindjës 28.06.1986, lindur në Strelcë dhe banues në Tiranë në adresën: Rruga Stavri Themeli, Pallati Xhero, Sh.1, Ap 27, Tirane 1023 , i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër personal I60628128D , madhore , me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

THEMELIMI

Neni 1

Themelohet Shoqëria tregtare "BIRDING ALBANIA" SHPK, e cila do ti nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare "BIRDING ALBANIA " SHPK do të jetë në adresën: – Rruga Stavri Themeli, Pallati Xhero, Sh.1, Ap 27, Tirane 1023 (Kodi unik: 82200271451, ZK 8220) .Domain : www.birdingalbania.com , e-mail : contact@birdingalbania.com ,Telefon : +355682000894.

Neni 3

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 4

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj Tregtar me objekt "Agjenci Turistike" si dhe "shërbim profesional në fushën e studimit të biodiversitetit dhe zhvillimit të turizmit natyror".

Shoqëria gjithashtu mund të kryejë të gjitha aktivitetet e tjera të cilat janë të lejuara sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 5

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes të mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.



KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lek (Njëqindmijë lekë), kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

- Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "BIRDING ALBANIA" SHPK do drejtohet nga Administratori i saj Z.Mirjan Topi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gjykon të nevojshme.

Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 10

Shoqëria tregtare "BIRDING ALBANIA" SHPK do ketë vulën e saj, në cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria tregtare "BIRDING ALBANIA" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në gjuhën shqipe dhe miratohet prej Ortakut të Vetëm duke u nënshkruar si më poshtë.

THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"BIRDING ALBANIA" SHPK

ORTAKU I VETËM

MIRJAN TOPI

Mirjan TOPI
